



## KOLEGJI ESLG

---

### **Procesverbali i takimit të Bordit Industrial të Programit**

***Pranishëm: Gent Sejdiu (CEO i KRG), Bajram Hoxha (CEO i Hoxha Invest Group)***

Bordi Industrial i programit master mbajti takimin më 09.04.2021 për të rishikuar implementimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Strategjisë së Përmirësimit të Cilësisë së programit master Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA) dhe i dha detyrën Z. Gent Sejdiu që të shërbejë si procesmbajtës.

Bordi Industrial i Programit rishikoi Qëllimin Strategjik 2.2 të Planit të Veprimit me aktivitetin Krijimi i Listës së Ekspertëve nga industria e ndërtimit dhe kompanitë e paluajtshmërive të cilët do të shërbejnë në Panelet Vlerësuese të Aktivitetit Interdisciplinar dhe përfunduan se afati kohor për minimum 8 përfaqësues të industrisë për të shërbyer në Panelin Vlerësues ishte 15.03.2021 si tregues i performansës. Plani i veprimit mund të gjendet në [http://www.eukos.org/repository/docs/Action\\_Plan\\_for\\_Improvement\\_Strategy.pdf](http://www.eukos.org/repository/docs/Action_Plan_for_Improvement_Strategy.pdf)

Bordi Industrial i Programit master gjithashtu intervistoi Arben Asllani (Intercapital) dhe kërkoi nga ai mendimin e tij për nominimet sa i përket përfaqësuesve të industrisë të cilët do të shërbenin në Panelin Vlerësues të Aktivitetit Interdisciplinar.

Z. Gent Sejdiu nominoi vetën dhe Z. Qemajl Pozhegu nga kompania ndërtimore Pozhegu Brothers, përderisa anëtar i intervistuar i industrisë ndërtimore nominoi vetën dhe përfaqësuesit e tre kompanive që të shërbejnë në Panelin Vlerësues si Durguti Invest me Enver Durguti, BP HOME Investment (Mentor Pllana) dhe Art Construction (Faton Sinani).

Bordi Industrial i Programit gjithashtu rishikoi qëllimin strategjik 10.3 që është rritja e përfshirjes së ekspertëve të industrisë në vlerësimin e punës studentore dhe si folës vizitor dhe përfundoi se përfaqësuesit e sipërpërmendur mund të shërbejnë si folës vizitor në programin master në semestrin veror 2020-2021 dhe semestrin dimëror 2021-2022.

Bordi Industrial i Programit përfundoi se për shkak se 15 lëndë duhet të mbahen gjithsejt në semestrin dimëror 2021-2022 dhe matës i performansës është një folës vizitor për dy lëndë, numri prej 6 folësve vizitor mjafton.

Prishtinë  
**Prishtinë më:  
08 prill  
2021**

**Procesmbajtës:  
Gent Sejdiu**



